



ITS

INSTITUTE FOR
TECHNOLOGY
AND SOCIETY

10 KËSHILLA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PËR GAZETAR



www.institutets.com
info@institutets.com



Ky udhëzues përfshin këshilla si dhe praktikat më të mira për t'iu ndihmuar të respektoni ligjin për mbrojtjen e të dhënave.

1. Mbrojtja e të dhënave është një pjesë e rëndësishme e gazetarisë:

- Të dhënat personale shpesh përbëjnë bazën e storjeve/artikujve që tregoni si gazetar. Sa herë që përdorni të dhëna personale, duhet të respektoni ligjin për mbrojtjen e të dhënave.
- Të dhënat personale janë çdo informacion në lidhje me një person të gjallë, të identifikueshëm që ruhen ose mbahen në një pajisje dixhitale si kompjuteri ose në kopje fizike.

Ligji për mbrojtjen e të dhënave fokusohet në shtatë parime kryesore për:

- të ndërmarrë hapa për mbrojtjen e të dhënave personale;
- t'i mbajtur të dhënat të sigurta;
- t'i përdorur ato në mënyrë të drejtë, të ligjshme dhe transparente;
- të përdorur të dhëna të sakta personale;
- t'i përdorni ato për një qëllim të caktuar;
- të mos përdorni më shumë të dhëna sesa keni nevojë; dhe
- të mbani të dhënat vetëm për aq kohë sa ju nevojiten.

2. Menaxhimi i rrezikut është çelësi për ti përmbushur kërkesat e mbrojtjes së të dhënave:

1. Sa më i madh rreziku i rrjedhjes apo keqpërdorimit të të dhënave personale, aq më e rëndësishme është që të mund të tregoni hapat që ndërmerrni për të mbrojtur ato.
2. Informohuni se si organizata juaj i mbron të dhënat personale. Zbuloni se çfarë procesi duhet të ndiqni. Mund të ketë politika ose procedura specifike për t'ju ndihmuar.
3. Sigurohuni që e kuptoni rolin dhe përgjegjësitë tuaja dhe pyesni nëse keni ndonjë pasiguri ose nevojë për mbështetje.
4. Ndiqni këshillat dhe direktivat më të fundit të sigurisë së të dhënave, veçanërisht kur punoni në distancë ose përdorni pajisje portative. Raportoni shkeljet e sigurisë së informacionit në organizatën tuaj.

Mos harroni të keni kujdes të shtuar në rast se:

1. ekziston rreziku i diskriminimit, humbjes financiare, dëmtimit të reputacionit, ose dëmtimit fizik;
2. jeni duke përdorur lloje të ndjeshme të të dhënave personale, veçanërisht të dhëna të kategorive të veçanta që zbulojnë racën e dikujt, bindjet politike ose fetare, të dhënat gjenetike, shëndetin ose jetën seksuale, ose të dhëna për vepër penale;
3. po përdorni të dhënat personale të fëmijëve ose të dhëna për persona të tjerë që mund të jenë të cenueshëm. Ata mund të mos kuptojnë rrezikun;
4. jeni duke përdorur materiale të marra online, veçanërisht nga mediat sociale ose përmbajtje të tjera të krijuara nga përdoruesit. Të dhënat e pasakta mund të përhapen shumë shpejt në internet dhe mund të jenë edhe dezinformata të qëllimshme.



3. Si i mbron aktivitetet gazetareske ligji për mbrojtjen e të dhënave personale:

- Si gazetarë, gjithmonë duhet të jeni në gjendje të tregoni se si jeni në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave dhe si i mbani të sigurtat të dhënat personale. Përrjashtimi zbatohet nëse:
 - besoni se është në interes të publikut; dhe
 - besoni në mënyrë të arsyeshme se respektimi i një pjese të caktuar të ligjit për mbrojtjen e të dhënave nuk është i mundur ose do të kufizonte në mënyrë të padrejtë aktivitetin tuaj gazetaresk
- Nëse përdorni ndonjëherë nga këto arsye, atëherë organizata juaj duhet të jetë në gjendje të tregojë se si ato zbatohen. Pra, sigurohuni që të kuptoni procesin organizativ për përdorimin e këtyre të dhënave, duke përfshirë personin që ka autoritetin për të marrë vendimin dhe nëse keni nevojë të mbani një procesverbal.

4. Ju duhet një arsye specifike ligjore për të përdorur të dhënat personale:

- Duhet të keni një arsye ligjore specifike për përdorimin e të dhënave personale. Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale i ofron gjashtë të tilla.
- Përpunimi për interes legjitim është shpesh arsyeja ligjore më e përshtatshme që ju ta përdorni për gazetari. Kjo ju lejon të mbledhni të dhëna personale nëse ka një interes publik në mbledhjen e të dhënave me përjashtim të rasteve kur interesat e tilla janë në kundërshtim me të drejtat dhe liritë themelore të subjektit të të dhënave.
- Pëlqimi i subjektit është gjithashtu një arsye ligjore, por shpesh e keqkuptuar. Nëse i jepni dikujt zgjedhje dhe kontroll të vërtetë, duke përfshirë të drejtën për të tërhequr pëlqimin në çdo moment.
- Ju nevojiten arsye ligjore më të forta për përdorimin e të dhënave personale të ndjeshme. Këto arsye janë përcaktuar në ligjin për mbrojtjen e të dhënave.

5. Përdorni të dhënat personale në mënyra të arsyeshme dhe në shërbim të interesit publik:

- Përdorni të dhënat personale në mënyrë të drejtë. Kjo nënkupton përdorimin e tyre në mënyrë të arsyeshme dhe që nuk shkakton dëm të pajustificueshëm.
- Faktorë të ndryshëm mund të jenë relevant, duke përfshirë nëse:
 - informacioni është i disponueshëm publikisht;
 - personi në fjalë ka një profil publik – edhe pse ju gjithmonë duhet të merrni parasysh edhe rrethanat tjera; dhe
 - ekziston rreziku i dëmtimit të personit.
- Si përfundim, drejtohuni nga ajo që është në interes të publikut. Në këtë proces duhet të konsiderohen faktorët pro dhe kundër publikimit, në raport me interesin publik.



6. Jini të qartë dhe të hapur me njerëzit për mënyrën se si i përdorni të dhënat e tyre personale kur mundeni:

- Organizata juaj në përgjithësi duhet t'u tregojë njerëzve për përdorimin e të dhënave personale nga ana e tyre duke ofruar informacione specifike për privatësinë.
- Informatat lidhur me politikën e privatësisë së organizatave duhet të jenë lehtë të qasshme.
- Pyetni personin përgjegjës në organizatën tuaj kur nuk jeni të sigurt nëse mbledhja e të dhënave është në rregull dhe kur duhet të ndani informata lidhur me politikën e privatësisë.

7. Kryeni kontrolle të arsyeshme të saktësisë:

- Se sa shumë duhet të kontrolloni saktësinë e informacionit, vare nga disa faktorë, përfshirë llojin e burimit që përdorni dhe rrezikun e dëmtimit të një personi. Sa më i madh të jetë rreziku i dëmtimit, aq më i kujdesshëm duhet të jeni.
- Edhe nëse storja/artikulli juaj duket rutinë dhe ju keni një afat të ngushtë, ju duhet të bëni kontrolle të arsyeshme.
- Bëni dallimin në mes të faktit dhe opinionit në raport me të dhënat personale në mënyrë që të siguroheni se ato janë të sakta.
- Nëse kontrollet tuaja normale të saktësisë nuk janë të mundshme, sigurohuni që të kuptoni se si organizata juaj pret që ju të menaxhoni rrezikun e përdorimit të të dhënave potencialisht të pasakta.

8. Përdorni vetëm informatat personale të nevojshme:

- Përdorni vetëm sasinë e nevojshme të të dhënave personale për të shkruar storjen/artikullin tuaj. Kjo ju ndihmon të jeni më efikas dhe të respektoni ligjin për mbrojtjen e të dhënave.
- Por ndonjëherë problemi është mungesa e të dhënave të mjaftueshme. Mbani mend se duhet të siguroheni që keni të dhëna të mjaftueshme për një storje/artikull të saktë.
- Pasi të përfundoni storjen/artikullin tuaj, analizoni nëse ka ndonjë të dhënë personale që nuk ju nevojitet ta mbani më. Nuk ka një kufizim kohor specifik në ligj, por ju nuk duhet t'i mbani të dhënat personale më gjatë se sa keni nevojë. Organizata juaj mund të ketë rregullat ose politikën e veta për këtë.



9. Ligji për mbrojtjen e të dhënave ofron një kuadër ligjor të sigurt për ju për të ndarë të dhënat me të tjerë:

- Kur njerëzit veprojnë në emër të organizatës suaj, si përkthyes të pavarur ose fotografë, ju duhet të keni një kontratë me shkrim që garanton se ata do të mbrojnë gjithashtu të dhënat personale.
- Nëse njerëz të tjerë ndajnë të dhëna personale me ju, për shembull burime për një storje/artikull, ju duhet të respektoni ligjin për mbrojtjen e të dhënave nëse dëshironi të përdorni të dhënat. Kjo është nëse nuk zbatohet përjashtimi i gazetarisë. (Shiko pikën nr. 2).

10. Ndhmoni njerëzit të ushtrojnë të drejtat e tyre për mbrojtjen e të dhënave

- Njerëzit kanë të drejta specifike sipas ligjit për mbrojtjen e të dhënave, duke përfshirë të drejtën për të kërkuar qasje në të dhënat e tyre dhe për t'ju kërkuar t'i ndryshoni, fshini ose korrigjoni ato. Ju duhet t'i ndihmoni njerëzit të përdorin të drejtat e tyre dhe të dini se çfarë të bëni nëse pranoni një kërkesë.
- Në disa rrethana, ju mund të refuzoni një kërkesë. Për shembull, nëse zbatohet një përjashtim, siç është përjashtimi gazetaresk, ose nëse kërkesa është qartazi e pabazuar ose e tepruar.
- Ekziston mbrojtje e fortë ligjore për burimet konfidenciale, kështu që ka shumë pak gjasa që dikush mundë të ketë qasje në këtë lloj të të dhënash.

**Keni ndonjë pyetje?
Na kontaktoni në:**

**www.institutets.com
info@institutets.com**

